

REKOMANDIMET NGA KONFERENCA E TRETË NDËRKOMBËTARE “HULUMTIMET NË TRANSPORT DHE TRANSFERIMI I NJOHURIVE NË SIGURINË RRUGORE”, 22 JANAR 2016

1. Të formohet një ekip vlerësues i përbërë nga të gjitha institucionet dhe organizatat që janë pjesë e Forumit të Kosovës për siguri në rrugë dhe jashtë saj, që të hulumtojnë dhe analizojnë situatën, me qëllim të identifikimit të shkaqeve të cilat ndikojnë në sigurinë në trafik.
2. Implementimi i “Intelligent Speed Assistance”, i cili u mundëson ngasësve të respektojnë limitet e shpejtësisë.
3. Marrja e përgjegjësive nga institucionet që kanë mandat për siguri në rrugë dhe konsolidimi i ligjeve të Kosovës me ato të BE-së, me qëllim të zvogëlimit të numrit të aksidenteve dhe përmirësimit të gjendjes aktuale.
4. Të mbështetet dhe përkrahet projekti kombëtar në shkallë vendi “Siguria në rrugë”, i cili ka filluar që nga viti 2013. Programet e tilla nuk duhet të prezantohen vetëm si fushatë në periudhë të shkurtër, por duhet të jenë pjesë e programeve edukative të shkollave fillore dhe të përditësohen sipas rrethanave dhe zhvillimeve në trafik. Të bëhet intervenimi në kurrikulën e teksteve shkollore, ashtu që ato të bartin tek nxënësit informacionet e duhura për trafikun, e kjo ndikon në edukimin e tyre për një sjellje të kulturuar në trafik.
5. Në bazë të hulumtimeve rezulton se rastet për kundërvajtje në trafik për shkak të çështjeve teknike nuk ekzekutohen nga organet gjyqësore, andaj sa më parë duhet të ndërmerren masa konkrete në mënyrë që të vendoset zero tolerancë për ata që shkelin ligjin dhe përbëjnë kërcënim për jetën e njerëzve.
6. Bashkëpunimi me mekanizmat vendor dhe ndërkombëtar për të forcuar rolin e kërkimeve për të filluar menaxhimin e politikës së sigurisë rrugore dhe njëkohësisht mundëson transferimin e njohurive më të fundit dhe praktikave më të reja të zhvilluara në Europë në fushën e sigurisë rrugore.
7. Përkrahja institucionale e AMRKS- së në funksionalizimin e shërbimeve mbështetëse për të gjithë pjesëmarrësit në rrugë, për ndihmë në rrugë (asistencë teknike). Koordinimi dhe harmonizimi i veprimeve si dhe trajnimi i dispeçerëve, të cilët punojnë në qendrat e thirrjeve emergjente. Instalimi i një softueri për numër më të madh të këtyre qendrave dhe monitorimi i tyre.

8. Në bazë të analizave dhe hulumtimeve të kryera rezultojnë që mënyra dhe niveli i ngasësve të automjeteve rrugore është larg nga niveli i duhur dhe trendet në këtë drejtim janë negative. Andaj institucionet kompetente duhet të marrin masa për përmirësimin e kontrollit dhe organizimin e sistemit të ngasësve të automjeteve, pra mënyrën e aftësisë dhe testimit të tyre. Ky shqetësim është ngritur edhe në dy Konferencat e kaluara, andaj kërkohen të merren masa të menjëhershme dhe konkrete nga Ministria e Infrastrukturës, si autoritet përgjegjës.
9. Kosova vazhdon të mbetet shteti i vetëm në region, e cila ende nuk është pjesë e AETR (European Agreement Concerning the Work of Crews of Vehicles Engaged in International Road Transport) për tahografë digjital. Me qëllim të trajtimit të barabartë të transportuesve vendor, urgjentisht duhet të fillohet organizimi i trajnimeve për tahografë digjital, i monitoruar nga Ministria e Infrastrukturës. Duke qenë se këto janë trajnime fillestare dhe periodike, obligohen edhe zyrtarët policor të njësisë së trafikut të përfundojnë trajnimin në fjalë.
10. Të futet në përdorim një sistem i integruar për kontrollë dhe çasje në tahografë digjital, ashtu siç kanë vepruar vendet e BE-së, ky sistem ka rezultuar shumë i suksesshëm në kontrollin e kohës së punës dhe kohës së vozitjes gjatë ngasjes së automjeteve transportuese. Suksesi i një sistemi të tillë është jo vetëm për organet e zbatimit të ligjit por edhe për vet kompanitë e transportit, të cilat kanë përfituar shumë në ngritjen e cilësisë së transportit, mënyrës së ngasjes së automjeteve dhe ekonomizimit të transportit në përgjithësi.
11. Auditimi i rrugëve dhe projekteve rrugore për standartet e sigurisë në rrugë si dhe funksionaliteti i tyre në raport me fluksin dhe nevojat sipas praktikave më të avancuara europiane.
12. Planet strategjike afatmesme dhe afatgjata për sigurinë në rrugë duhet të përfshijnë praktikën më të mirë nga vendet e BE-së, megjithatë të mos jenë vetëm një kopje e vendeve të BE-së, sepse ato duhet gjithashtu të marrin në konsideratë rrethanat dhe mundësitë që ekzistojnë në Kosovë.
13. Ndarja e një buxheti të posaçëm për zhvillimin e aktiviteteve për sigurinë në rrugë si dhe mbështetja e hartimit të një strategjie për të lënduarit si pasojë e aksidenteve në trafik.
14. Vetëdijësimi i qytetarëve, aplikimi i sistemit të mbledhjes së pikave për patentë shoferë, vendosja si prioritet i sigurisë rrugore dhe përkrahja nga qeveria, janë vetëm disa nga mënyrat më efektive për përmirësimin e sigurisë në rrugë. Natyrisht se për aplikimin e një sistemi të tillë është i nevojshëm koordinimi i punëve dhe

përgjegjësi në mes të institucioneve përgjegjëse (Policia e Kosovës, Gjykatat, Ministrinë).

15. Të rritet përgjegjësia në qendrat e kontrollit të automjeteve, përmirësimi i gjendjes së rrugëve, shenjzimi rrugor (rishikimi i shenjzimit dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e shenjave të komunikacionit sidomos në zonat rurale, kjo pasi në zona të tilla mungojnë).